# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6137
E martë, 13 tetor 2020
çmimi 0.40 €


## Lajçak sot vjen në Kosovë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME FAQE 4-5

# MIRATOHET NË PARIM PROJEKTLIGJI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE



Më në fund Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në parim Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Tek për herën e shtatë ky projektligj ka arritur t'i marrë 64 vota të deputetëve. Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës nuk e kanë votuar këtë projektligj. Përveç deputetëve të koalicionit qeverisës, pro këtij projektligji kanë votuar kryeparlamentarja Vjosa Osmani, deputeti Haxhi Avdyli dhe dy deputetët e AKR-së. Nga partia e kryeministrit Avdullah Hoti është bërë me dije se ky projektligj pritet të dalë për miratim në lexim të dytë brenda dy javësh

# GLPS-ja: KPK-ja PO ABUZON ME LIGJIN, TË ANULOHEN KONKURSET PËR KRYEPROKURORË

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), duke iu referuar zhvillimeve të fundit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka vlerësuar se ky këshill është duke abuzuar me ligjin. Në këtë kontekst, kjo organizatë ka kërkuar nga KPK-ja që t'i anulojë konkurset për kryeprokurorë pasi nga procesi i monitorimit të këtij procesi janë tërhequr partnerët kryesorë ndërkombëtarë. "KPK-ja, në vend se të ishte shembull i garantimit të zbatimit minimal të parimeve të transparencës, ndalimit të konfliktit të interesit dhe integritetit të lartë moral, është bërë sinonim i keqpërdorimit të pushtetit publik që ne e hasim në nivel të partive e të qeverisë", është thënë në reagimin e GLPS-së FAQE 7






# NJË I VDEKUR DHE 68 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

FAQE 3

## OPINION

SA LEHTË MASHTROHEMI, POR EDHE NA MASHTROJNË! F. 11

Nga KMDLNj

## AKTUALE

QEVERIA MIRATON RREGULLOREN PËR ATASHETË F. 5

KURTESHI: KQZ-ja PO E PENGON TË DREJTËN E VOTËS NË KOSOVË F. 7

SELIMI: MINISTRIA E DREJTËSISË DO T'U QËNDROJË KRAH LUFTËTARËVE TË UÇK-së F. 6



## EKONOMI



HOTI: PO PËRMBYLLEN AKSET KRYESORE RRUGORE NË VEND F. 9

SHTYHET DERI MË 31 DHJETOR AFATI PËR LAJMËRIMIN E PENSIONISTËVE PËR PENSIONE F. 8

KRASNIQI KËRKON QË BE-ja T'I BËJË SERBISË PRESION PËR RESPEKTIMIN E MARRËVESHJES SË CEFTA-s F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Nga e enjtja maskat në Shqipëri, të detyrueshme



TIRANË, 12 TETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, ka dhënë një mesazh për të gjithë qytetarët e Shqipërisë për sa iu përket masave anti Covid-19. Veliu ka bërë një reagim lidhur me masën e re që pritet të hyjë në fuqi nga dita e enjte dhe që u njoftua më parë nga kryeministri Edi Rama ku çdo qytetar është i detyruar ta mbajë maskën mbrojtëse që në momentin kur del prej shtëpisë së vet. Sipas Ardi Veliut, me marrjen e një mase të tillë synojmë edhe të shmangim një mbyllje si ajo e pranverës së këtij viti. Ai shton se për qytetarët është më e lehtë të mbajnë një maskë dhe t'i zbatojnë rregullat e distancimit social sesa t'u nënshtrohen kushteve të rrepta të mbylljes. "Policia e Shtetit do të angazhohet me të gjitha kapacitetet e saj, në krahë të strukturave të tjera, për ta garantuar zbatimin e masave të caktuara nga autoritetet e Shëndetësisë. Patrullat policore do t'i monitorojnë në mënyrë rigoroze të gjithë ambientet dhe hapësirat publike ku nga e enjtja do të jetë detyrim mbajtja e maskës. Patrullat policore do t'i monitorojnë në mënyrë rigoroze të gjithë ambientet dhe hapësirat publike ku nga e enjtja do të jetë detyrim mbajtja e maskës", ka thënë Veliu.

# Lajçak sot vjen në Kosovë



PRISHTINË, 12 TETOR - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, do të qëndrojë të martën në Kosovë. Nga Qeveria e Kosovës e konfirmuan lajmin për "Radion Evropa e Lirë", por nuk u dhanë detaje rreth agjendës së diplomatit. Të hënën Lajçak iu adresua ministrave të Jashtëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi. "Jam mirënjohës për interesin e tyre të sinqertë dhe mbështetjen e fuqishme. Diskutimi i sotëm konfirmoi se dialogu është qartazi i lidhur me të ardhmen evropiane të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Lajçak në një postim në llogarinë e vet në "Twitter". Ministrat e jashtëm të BE-së u mblodhën të hënën për të diskutuar një sërë çështjesh, përfshirë dialogun Kosovë - Serbi, sanksionet e mundshme ndaj Rusisë për rolin e saj të pretenduar në helmimin e politikanit të opozitës Aleksei Navalny, si dhe situatën në Bjellorusi. Dialogu Kosovë - Serbi, që synon normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, ka nisur qysh në vitin 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara.

# Borrelli: Suksesi i dialogut, çelës për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së

BRUKSEL, 12 TETOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka thënë se suksesi në dialogun Kosovë - Serbi është çelës për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe në vetë Bashkimin Evropian. Ai ka folur në konferencë për media pas takimit me ministrat e Jashtëm të BE-së. Ai ka treguar se emisari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka njoftuar ministrat për ecurinë e dialogut. "Dialogu Prishtinë - Beograd, Lajçaku e ka njoftuar Këshillin dhe ne mbetemi të përkushtuar për ta sjellë dialogun në një përfundim të suksesshëm. U kërkojmë palëve të punojnë në frymë të mirëbesimit dhe bashkëpunimit e kompromisit. Suksesi i dialogut është çelës për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe BE-në. Këshilli ka ofruar përkrahjen e plotë në këtë aspekt dhe përkrahje të fuqishme për punën e Lajçakut", ka thënë Borrell.



## Kodi i ri zgjedhor, Rama mesazh të prerë Metës: Firmose ose ktheje sa më shpejt!



TIRANË, 12 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, me anë të një prononcimi për media ka folur rreth miratimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, duke dhënë një mesazh të prerë për presidentin Ilir Meta. Rama ka thënë se nëse ndryshimet në Kodin Zgjedhor do të kthehen në Kuvend nga presidenti Ilir Meta, siç ky i fundit ka paralajmëruar, Kuvendi do t'i votojë sërish. Rama është pyetur edhe për planin pesëpikësh të kreut të Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, duke thënë se "nuk ia ka idenë këtij lloj plani". "Nëse presidenti Ilir Meta dërgon në Kuvend kthim të Kodit Zgjedhor, do të rrëzohet. Nuk ia kam idenë për plan me 5 pika të Lulzim Bashës. 5 qershori është respektuar. 30 qershori është respektuar dhe nuk ka asgjë më për të thënë dhe s'ka kohë për të humbur. Presidenti bën mirë ta firmosë ose ta kthejë sa më parë. Pasi më nuk kohë për implementim", ka thënë Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Një i vdekur, 33 të shëruar dhe 68 raste të reja me Covid-19

# Një i vdekur dhe 68 raste të reja me Covid në Kosovë

Në Kosovë janë konfirmuar të hënën 68 raste të reja me koronavirus dhe një viktimë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka treguar se në 24 orët e fundit janë shëruar 33 pacientë, ndërsa nga e hëna qytetarët e Maqedonisë së Veriut mund të hyjnë në Kosovë pa test për Covid-19



## Hoti: Shtrëngimi i masave, konform rekomandimeve

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vizituar Institutin e Mjekësisë Ligjore. Hoti ka thënë se ditëve më vazhdim do të pranojnë një elaborat për nevojat e institutit në mënyrë që të lehtësohet puna për përmbylljen e identifikimit të 300 mbetjeve mortore. "Diskutuam që në ditët e ardhshme do të pranojmë një elaborat për nevojat që i ka Instituti dhe Komisioni për të Pagjetur në mënyrë që të lehtësohet puna edhe për përmbylljen e 300 mbetjeve mortore që janë në institutit. Kjo është çështja më e ndjeshme edhe për familjet që ende presin të dinë për fatin e familjarëve të tyre", ka thënë Hoti. Ai ka folur edhe për shtrëngimin e masave anti-Covid, ku ka thënë se çdo gjë do të bëhet konform rekomandimeve. "Ju jeni në dijeni për protokollet se si funksionojnë shkollat dhe në atë moment që paraqitet një rast, shkolla do të mbyllet, edhe masat do të merren konform rekomandimeve", është shprehur Hoti. Ndërsa drejtori i Institutit, Arsim Gërxhaliu, ka falënderuar Hotin për vizitën si dhe ka kërkuar ndihmë nga institucionet e vendit.



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve një person ka vdekur nga Covid-19. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar 68 raste të reja të infektimit me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 702 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 68 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast Klinika Infektive, QKUK). Numri total i rasteve pozitive është 16 247 raste nga 75 288 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 648 raste të vdekjes", është thënë në njoftim, duke treguar se 33 pacientë janë shëruar nga koronavirusi. "Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 33 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 368 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 231. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 21 raste, komuna Gjilan 11 raste, komuna Gjakovë 10 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Pejë 6 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Podujevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Klinë, Lipjan, Mitrovicë, Prizren, Shtime dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën", ka treguar IKShPK-ja.

### Qytetarët e Maqedonisë tani e tutje mund të hyjnë në Kosovë pa test për Covid

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka njoftuar se qytetarët e Maqedonisë së Veriut nga sot mund të hyjnë në Kosovë pa test për Covid-19. Në profilin e vet në "Facebook", Zemaj ka shkruar se nga ky rregull përjashtohen shtetet që, sipas ECDC, klasifikohen shtete me rrezik të lartë për Covid-19. "Me mikun tim, zëvendësministrin e Shëndetësisë, z. Ilir Hasani, e nisa javën në Prishtinë. Teksa po pinim kafe, po flisnim për një bashkërendim sa më të mirë të aktiviteteve që kanë të bëjnë me shëndetin e qytetarëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Sipas parimit të reciprocitetit, qytetarët nga Republika e Maqedonisë së Veriut nga sot mund të hyjnë në Kosovë pa testin PCR. Nga ky rregull përjashtohen shtetet që, sipas ECDC, klasifikohen shtete me rrezik të lartë për Covid-19", ka shkruar ai. Zemaj ka treguar se testet PCR mund të kthehen nëse vërehet se ka rritjet të rasteve të infeksionit. "Testet PCR mund të kthehen nëse vërejmë se ka rritje të rasteve të infeksionit. U bëjmë thirrje qytetarëve të të dyja vendeve, të jenë të kujdesshëm, t'u përmbahen rekomandimeve dhe të udhëtojnë në shtetet e ndërsjella, nëse e kanë të domosdoshme. Duhet angazhim i përbashkët për shëndetin e qytetarëve të vendeve tona dhe rajonit!", ka vlerësuar Zemaj.



## Zemaj e Mehmeti diskutojnë për bashkëpunimin MSh - BQK në situatën e pandemisë

PRISHTINË, 12 TETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj. Në takim është diskutuar për masat që i ka ndërmarrë BQK-ja për ndihmë ekonomisë, por edhe për respektimin e të gjitha masave të kërkuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Guvernatori Mehmeti dhe ministri Zemaj adresuan mbarëvajtjen e procesit të policave të sigurimit shëndetësor dhe çështjen e mbulueshmërisë së sigurimeve shëndetësore nga kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë në trajtimin e rasteve te Covid-19.

Në këtë kontekst u diskutuan edhe zhvillimet dhe dinamika për plotësimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore dhe sfidat të cilat duhet të adresohen përmes këtij ligji, në veçanti situatat e ballafaqimit me pandemi të përmasave globale siç është Covid-19.

Më tutje, guvernatori tha se BQK-ja do të vazhdojë t'i mbështesë të gjitha institucionet relevante në iniciativa ligjore, por edhe në implementim e të gjitha udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për ta parandaluar përhapjen e Covid-19, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe ballafaqimit me pasoja sa më të lehta për menaxhimin e kësaj pandemie.

Nga ana tjetër, ministri Zemaj ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për masat e ndërmarra kundër pandemisë dhe ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe më tutje me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik që do të jetë në funksion të ruajtjes dhe rimëkëmbjes së ekonomisë.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme

# MIRATOHET NË PARIM PROJEKTLIGJI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Më në fund, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në parim Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Tek për herën e shtatë ky projektligj ka arritur t'i marrë 64 vota të deputetëve. Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës nuk e kanë votuar këtë projektligj. Përveç deputetëve të koalicionit qeverisës, pro këtij projektligji kanë votuar kryeparlamentarja Vjosa Osmani, deputeti Haxhi Avdyli dhe dy deputetët e AKR-së. Nga partia e kryeministrit Avdullah Hoti është bërë me dije se ky projektligj pritet të dalë për miratim në lexim të dytë brenda dy javësh

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky projektligj është votuar në seancën e jashtëzakonshme të së hënës, me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, pas gjashtë dështimesh të mëhershme. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili është votuar të hënën, pritet të kalojë në lexim të dytë pas dy javësh. Kështu ka bërë me dije shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi.
Projektligjin në fjalë nuk e kanë votuar partitë në opozitë, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e bizneseve dhe nuk përkon asgjë me rimëkëmbje ekonomike. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, e ka deklaruar votën e saj pro këtij projektligji, ndonëse e ka kritikuar qeverinë. Para votimit ajo ka thënë se si kryetare e Kuvendit në asnjë moment nuk është konsultuar, nuk është kontaktuar apo nuk është kërkuar mbështetje për këtë ligj nga ana e Qeverisë së Kosovës. "Kjo tregon se sa lodhet kjo qeveri për këtë ligj. Me vetë faktin se sot as kryeministri nuk është këtu, tregon se nuk lodhen aspak për dëmin ekonomik të shkaktuar nga pandemia", ka deklaruar Osmani. Sipas saj, rruga që ka zgjedhur qeveria nuk është mënyra për të bashkëpunuar me opozitën për çështje të rëndësishme. "Jam këtu për të treguar se, siç e kam votuar për pesë e më shumë hera të tjera, unë e votoj edhe sot, jo se e meritoni ju këtë votë, sepse në vend se të tregoni bashkëpunim, keni treguar arrogancë të paparë, edhe injorancë po", ka thënë ajo. Përveç deputetëve të koalicionit qeverisës dhe kryeparlamentares, pro këtij projektligji ka votuar deputeti Haxhi Avdyli dhe dy deputetët e AKR-së.
Ndërsa qeveria ka falënderuar deputetët për votimin e këtij projektligji. Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka përgëzuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratim në lexim të parë të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, duke thënë se projektligji iu hap rrugë institucioneve shtetërore për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19. "Përgëzoj deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratimin në lexim të parë të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Tani, sipas procedurave parlamentare, shpresoj në miratim edhe në lexim të dytë të këtij projektligji, në mënyrë që t'u hapet rrugë institucioneve shtetërore për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Ndër të tjera, ky projektligj u mundëson qytetarëve të vendit tërheqjen e 10 për qind të mjeteve të tyre në Trust", ka shkruar Balaj-Halimaj në profilin e vet në "Facebook".
Edhe ministrja e Financave, Hikmete Bajrami, ka falënderuar të gjithë deputetët që votuan Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, duke thënë se pret bashkëpunim mes dy leximeve.
Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike kap vlerën e 385 milionë eurove. Me miratimin e këtij projektligji është thënë se do të mundësohet rikuperimi i humbjeve të bizneseve për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi. Një projektligj që votohet në lexim të parë, sipas procedurës së rregullt, i duhen së paku dy javë që të shqyrtohet në komisionet funksionale të kuvendit. Nëse një projektligj futet në procedurë të përshpejtuar, atëherë duhet të kërkohet shmangie nga Rregullorja e Kuvendit me 2/3 e votave të deputetëve. Bizneset në Kosovë gati në të gjithë sektorët kanë raportuar vlera të mëdha të humbjeve financiare dhe zvogëlim të kapaciteteve prodhuese, nga masat e marra nga qeveria më 13 mars për parandalimin e pandemisë. Për këtë arsye subjektet ekonomike në Kosovë disa herë kanë kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta votojnë këtë projektligj pasi, sipas tyre, adresimi i dëmeve të shkaktuar në ekonomi është thelbësor për shpëtimin e ndërmarrjeve dhe punonjësve të goditur nga pandemia Covid-19.

### Çka parasheh Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike?

Në Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike thuhet se "Fondi Kreditor Garantues i Kosovës, (FKGK) autorizohet të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës nga 50 deri në 80 për qind". Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që u lëshon garanci institucioneve financiare për ta mbuluar rrezikun për kreditë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, sipas këtij projektligji, kontributpaguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
Tërheqja e këtyre mjeteve nuk



është përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sipas të cilit, "kjo zvogëlon pensionet e ardhshme". Më pas, mjetet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore mund të përdoren për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me qëllim të realizimit të rimëkëmbjes ekonomike, përjashtuar kategorinë e pagave dhe shtesave. E me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, Ministria e Financave mund ta shtyjë afatin e pagesës së tatimeve deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kriteret për shtyrjen e afateve përcaktohen nga Ministria e Financave. Për bizneset që nuk arrijnë ta bëjnë pagesën e deklaratës tatimore nuk shqiptohet ndonjë ndëshkim, me kusht që pagesa të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2021.

Ky projektligj– nëse votohet në Kuvendin e Kosovës edhe në leximin e dytë dhe shndërrohet në ligj – do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021. Pas kësaj date, të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike.

## Shefi i Zyrës i BE-së mirëpret miratimin e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, është shprehur i lumtur pas miratimit në parim të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ai shpreson se deputetët do t'i kenë parasysh komentet e bëra nga BE-ja për këtë projektligj. "I lumtur që Kuvendi i Kosovës përfundimisht arriti që me sukses ta kalojë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike në lexim të parë. Shpresoj që deputetët do t'i kenë parasysh komentet e bëra nga BE-ja dhe faktorët e tjerë ndërkombëtar në punën për finalizimin e këtij ligji të domosdoshëm", ka thënë ai.

Edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, është shprehur i kënaqur për kalimin në lexim të parë të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike në Kuvendin e Kosovës.

## Mustafa: Lufta për t'i mposhtur pasojat nga pandemia është detyrim i të gjithëve

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka uruar deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratimin në parim të Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike. Ai ka vlerësuar se miratimi i këtij projektligji është një hap i rëndësishëm për ta fituar betejën me pasojat ekonomike dhe sociale nga pandemia Covid-19. "Miratimi në lexim të parë i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është një hap i rëndësishëm për ta fituar betejën me pasojat ekonomike dhe sociale nga pandemia Covid-19. Uroj deputetët që e votuan. Lufta për t'i mposhtur pasojat nga pandemia është detyrim i të gjithëve, pozitës dhe opozitës, nga fakti se nuk kemi dy pandemi, njërën për pozitën e tjetrën për opozitën, por një Covid-19 që po i prek qytetarët pa dallim", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook", duke e inkurajuar pozitën dhe opozitën të bashkëpunojnë për këtë projektligj në leximin e dytë. "Inkurajoj një bashkëpunim racional të të gjitha grupeve parlamentare dhe të të gjithë deputetëve dhe qeverisë për plotësimin dhe begatimin e këtij projektligji në mënyrë që ai të jetë sa më gjithëpërfshirës deri në aprovimin e tij si ligj në leximin e dytë", ka shkruar Mustafa.

# Qeveria miraton rregulloren për atashetë

PRISHTINË, 12 TETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e 34-t me radhë, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar rregullore dhe vendime të fushës së përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore.



Në hapje të mbledhjes, kryeministri Avdullah Hoti ka njoftuar se ka pranuar raportin për Kosovën të Komisionit Evropian, i cili evidenton përparimin në të gjitha fushat si dhe sfidat në funksionimin dhe zhvillimin e përgjithshëm në shoqërinë tonë. Ky raport konfirmon se Kosova vazhdon t'i mbajë të plotësuara të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe thekson vlerësimin pozitiv të Qeverisë së Kosovës për sigurinë, stabilitetin dhe fqinjësinë e mirë në rajon. Kryeministri Hoti ka theksuar se ai tashmë ka filluar diskutimin për t'i adresuar të gjitha sfidat e evidentuara në raport.

Rregullorja për atashetë e mbrojtjes ka marrë miratimin nga kabineti qeveritar në këtë mbledhje. Kjo Rregullore përcakton statusin, detyrat dhe përgjegjësitë, procesin e përzgjedhjes, pranim-dorëzimin e detyrës, kohëzgjatjen e shërbimit, pagesën, kompensimet e tjera dhe ndërprerjen e shërbimit të Atasheut të Mbrojtjes dhe oficerit ndërlidhës të akredituar në misionin diplomatik të Republikës së Kosovës në vendet e tjera apo në organizata ndërkombëtare.

Zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, sipas vendimit të miratuar në mbledhjen e qeverisë, do ta përfaqësojë Qeverinë në punimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Duke vepruar sipas kërkesës së Këshillit Konsultativ të Komuniteteve, i cili vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës ka emëruar tre përfaqësues të lartë nga qeveria për anëtarë të Këshillit Konsultativ për Komunitete. Qeveria ka propozuar këta anëtarë: Ivan Millojeviq, Lindon Pajaziti dhe Suad Ademi.

Qeveria ka shfuqizuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.08.2020 për aprovimin e Koncept Dokumentit për themelimin e Agjencisë për Integrim Evropian. Me vendimin e miratuar nga qeveria, janë shfuqizuar 23 vendime për dhënie të pëlqimit për përjashtim nga fushëveprimi i procedurave të Ligjit për prokurim publik në Republikën e Kosovës. Vendimi obligon të gjitha institucionet që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me këtë ligj.

Në këtë mbledhje është miratuar edhe vendimi për zbatimin e Masës-9 për rimëkëmbje ekonomike sipas planit të detajuar me fokus në komunitetet joshumicë, të cilin e ka përgatitur Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit. Plani përmban objektiva konkrete të mënyrës së zbatimit si dhe kritere të qarta për shfrytëzuesit, kushtet e aplikimit dhe format për vlerësim, zbatim dhe monitorim të procedurës për realizimin e masave. Objektivi i parë synon sigurimin e nevojave themelore të jetesës për personat në nevojë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, ndërsa objektivi i dytë synon zbutjen e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia e virusit Covid-19 ndaj ndërmarrjeve të vogla, kurse objektivi i tretë ofrimin e shërbimeve të gerontologjisë personave në nevojë nga komunitetet joshumicë; dhe objektivi i katërt ngritjen e vetëdijes te banorët me qëllim të parandalimit të përhapjes së mëtejme të virusit Covid-19.

# Hoti zhvillon bisedë telefonike me kryeministrin grek

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar sot një bisedë telefonike me homologun e vet grek Kyriakos Mitsotakis, me të cilin kanë biseduar për zhvillimet politike në vend. Në postimin e tij në "Facebook", Hoti ka shkruar se roli mbështetës i Greqisë për Kosovën është tepër i rëndësishëm. "Sot zhvillova një bisedë telefonike me kryeministrin e Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, me të cilin biseduam për zhvillimet politike në vend, thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, kryesisht në fushën ekonomike, procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për procesin e liberalizimit të vizave, me ç'rast Kosova tash e sa kohë i ka të plotësuara të gjitha kushtet. Roli mbështetës i Greqisë për Kosovën është tepër i rëndësishëm, ngaqë është vend anëtar i BE-së dhe NATO-s, organizata këto që Kosova aspiron të jetë pjesë e tyre", ka shkruar Hoti.



# Kosovë, 40 të dënuar për krime lufte

Në Kosovë janë të dënuar 40 persona për krime lufte. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare në Prishtinë, nga 40 personat e dënuar në Kosovë për krime lufte, 34 janë shqiptarë, pesë serbë dhe një rom. Në Serbi është bërë shumë më pak sa i përket dënimit të atyre që kanë kryer krime në luftën e viteve 1998-1999. Që nga përfundimi i luftës në Kosovë në Serbi janë gjykuar vetëm 17 persona, prej tyre dy janë shqiptarë. Për krime lufte në Kosovë janë mbajtur edhe dy procese gjyqësore në Mal të Zi dhe është dënuar një malazez. Në Hagë janë dënuar gjashtë serbë për krime lufte në Kosovë, të cilët kanë pasur pozitat e eprorëve ushtarakë dhe politikë. Po ashtu, janë dënuar edhe dy ish-ushtarë të UÇK-së që kanë pasur pozita më të ulëta


Armend Nimani (AFP)

**Prishtinë, 12 tetor** - Dy dekada pas përfundimit të luftës së fundit, për krime lufte në Kosovë, nga gjyqësori vendor, duke i përfshirë edhe misionet ndërkombëtare, janë akuzuar 116 persona dhe janë dënuar 40 prej tyre. Rreth 40 janë liruar, kurse 28 persona janë arratisur pas ngritjes së aktakuzës, prej tyre 24 serbë. Ata janë dënuar nga gjykatat vendore, përfshirë misionet ndërkombëtare, UNMIK-u dhe EULEX-i. Mirëpo, që nga data 13 maj 2015 është krijuar Departamenti për Krimet e Luftës në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Kur kanë kaluar më shumë se pesë vjet janë ngritur shtatë aktakuza nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pas fillimit të pranimit të kompetencave ekzekutive nga misioni i EULEX-it, dy prej të akuzuarve janë liruar e të tjerët janë ende në proces.

"Radio Evropa e Lirë" ka tentuar të marrë një përgjigje nga Prokuroria Speciale, por nga ky institucion i drejtësisë nuk janë deklaruar lidhur me këtë çështje. Analisti ligjor në Fondin për të Drejtën Humanitare në Prishtinë, Amer Alija, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për dënimin e atyre që kryen krime. "Institucionet në Kosovë duhet të hulumtojnë dhe të përgatisin sa më shumë raste dhe të tentojnë që përmes INTERPOL-it t'i arrestojnë edhe individët që nuk jetojnë në Kosovë dhe që janë të pakapshëm për organet e drejtësisë së Kosovës", ka thënë Alija. Ai ka shtuar se që ky proces të jetë më i lehtë, duhet që të ketë një bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Po ashtu përmes bashkësisë ndërkombëtare duhet insistuar që të krijohet një bashkëpunim juridik i shëndoshë në mes të Kosovës dhe Serbisë, për shkëmbimin e informatave që do të ndihmonin në arrestimin dhe gjykimin e sa më shumë kryesve të krimeve të luftës në Kosovë", ka theksuar ai. Që nga mbarimi i luftës, më 1999, krimet e luftës janë hetuar nga gjyqtarë dhe prokurorë të huaj, kurse nga viti 2015 këtë rol e kanë marrë institucionet e Kosovës.

Avokati Taulant Hodaj ka thënë se janë disa arsye pse gjyqësori në Kosovë nuk ka qenë efektiv sa i përket dënimit të atyre që kryen krime gjatë luftës. "Gjykatat vendore, problem kryesor, po ashtu edhe prokuroritë kanë që t'i dënojnë apo t'i ndjekin kryerësit e veprave penale që janë në fushëveprimin e krimeve të luftës. Është mungesa ose mospasja të drejtë e gjykimeve në mungesë deri tani, megjithëse kohët e fundit është ndryshuar ligji ku për krimet e luftës mund të vazhdojë gjykimi edhe në mungesë", ka thënë Hodaj. Po ashtu, problem tjetër sipas avokatit Hodaj është edhe mungesa e ekspertizës, pasi nuk ka hetues dhe prokurorë që kanë përvojë të hetimeve të krimeve të luftës.

Këto dhe çështje të tjera, sipas avokatit Hodaj, kanë bërë që të ketë nevojë për një gjykatë si Gjykata Speciale, që të merret me krimet e pretenduara të luftës në Kosovë. "Gjyqësori ka pasur mungesë të vullnetit që të ballafaqohet me kryerësit shqiptarë potencialë që mund të kenë kryer krime të luftës. Po ashtu, edhe ndikimi në dëshmitarë dhe mosmbrojtja e dëshmitarëve ka qenë një prej arsyeve pse është marrë vendimi që të themelohet Gjykata Speciale", ka thënë Hodaj.

Nga 40 personat e dënuar në Kosovë për krime lufte, 34 janë shqiptarë, pesë serbë dhe një rom, ka njoftuar Fondi për të Drejtën Humanitare në Prishtinë. Në Serbi është bërë shumë më pak sa i përket dënimit të atyre që kryen krime në luftën e viteve 1998-1999. Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, në Serbi janë gjykuar vetëm 17 persona, prej tyre dy janë shqiptarë. Për krime lufte në Kosovë janë mbajtur edhe dy procese gjyqësore në Mal të Zi dhe është dënuar një malazez. Në Hagë janë dënuar gjashtë serbë për krime lufte në Kosovë, të cilët kanë pasur pozitat e eprorëve ushtarakë dhe politikë. Po ashtu, janë dënuar edhe dy ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kanë pasur pozita më të ulëta.

Ndërkohë Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë është duke i hetuar krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty. Më 24 shtator, Dhomat e Specializuara në Hagë bën publike aktakuzën për krime lufte ndaj ish-eprorit të UÇK-së në zonën e Llapit, Salih Mustafa. Mustafa, i cili u arrestua dhe u dërgua në paraburgim në Hagë, akuzohet nga Gjykata Speciale (v.j. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar) për "ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, si krime lufte të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar në Kosovë, ose në lidhje me atë konflikt". Në aktakuzën ndaj Mustafës thuhet se "afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në një kompleks ndalimi në Zllash, Kosovë, u kryen krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe të torturës kundër të paktën gjashtë personave". Në aktakuzë përmendet, po ashtu, se prej periudhës 19 prill të vitit 1999 e deri në fund të atij muaji, në atë vendndodhje është vrarë një i ndaluar. Ndryshe, gjatë luftës në Kosovë humbën jetën rreth 13 500 persona, ndërsa 1 600 ende konsiderohen të pagjetur.



## Selimi: Ministria e Drejtësisë do t'iu qëndrojë krah luftëtarëve të UÇK-së

**Prishtinë, 12** - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka takuar sot sekretarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se me Klinakun ka diskutuar lidhur me arrestimet e krerëve të OVLUÇK-së. Ai ka thënë se Ministria e Drejtësisë do t'iu qëndrojë krah të gjithë luftëtarëve të lirisë. "Me Faton Klinakun, sekretarin e Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, këmbyem mendime për zhvillimet e fundit lidhur me arrestimet e krerëve të OVL-së. Ministria e Drejtësisë do t'iu qëndrojë krah të gjithë luftëtarëve të lirisë, duke ua ofruar kushtet e nevojshme për mbrojtje bazuar në ligjin dhe udhëzimet administrative në fuqi", ka shkruar Selimi.

# GLPS-ja: KPK-ja po abuzon me ligjin, të anulohen konkurset për kryeprokurorë

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), duke iu referuar zhvillimeve të fundit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka vlerësuar se ky këshill është duke abuzuar me ligjin. Në këtë kontekst, kjo organizatë ka kërkuar nga KPK-ja që t'i anulojë konkurset për kryeprokurorë, pasi nga procesi i monitorimit të këtij procesi janë tërhequr partnerët kryesorë ndërkombëtarë. "KPK-ja, në vend se të ishte shembull i garantimit të zbatimit minimal të parimeve të transparencës, ndalimit të konfliktit të interesit dhe integritetit të lartë moral, ajo është bërë sinonim i keqpërdorimit të pushtetit publik që ne e hasim në nivel të partive e të qeverisë", është thënë në reagimin e GLPS-së




**Prishtinë, 12 tetor** - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka reaguar ndaj veprimeve të fundit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) sa i përket kundërshtimit të saj për ta njohur ekzistencën e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe prishjen e imazhit të Kosovës në raport me partnerët ndërkombëtarë. Nëpërmjet një reagimi publik, GLPS-ja ka vlerësuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) është duke abuzuar me ligjin. Sipas GLPS-së, Këshillin Prokurorial i Kosovës nuk është duke e njohur Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. "Siç jemi të gjithë në dijeni, organi përgjegjës për ta menaxhuar zinxhirin më të rëndësishëm të luftës ndaj krimit e korrupsionit, KPK-ja, së fundmi është bërë subjekt që kundërshton ekzistencën e ligjit special që parandalon konfliktin e interesit në Republikën e Kosovës, për ç'gjë Ambasada e ShBA-së dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë kanë braktisur monitorimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të KPK-së dhe kryeprokurorëve në njësitë prokuroriale. KPK-ja, në vend se të ishte shembull i garantimit të zbatimit minimal të parimeve të transparencës, ndalimit të konfliktit të interesit dhe integritetit të lartë moral, ajo është bërë sinonim i keqpërdorimit të pushtetit publik që ne e hasim në nivel të partive e të qeverisë. Një prishje e imazhit në përmasa të tilla i jep argument të fortë Komisionit Evropian që ta rishqyrtojë pozicionin e tij sa i përket dhënies së rekomandimit për heqjen e vizave për Republikën e Kosovës", është thënë në reagimin e kësaj organizate.

GLPS-ja ka theksuar se është e brengosur me rehatinë me të cilën KPK-ja arsyeton vazhdimin e procesit për zgjedhjen e kryeprokurorëve në njësitë prokuroriale, duke mos njohur ekzistencën e këtij ligji. "Kjo i bie që praktikisht KPK-ja po thotë që Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit nuk zbatohet mbi ta. Në të njëjtën linjë, ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, iu bashkëngjit këtij argumenti, duke pranuar që sa më shpejt të adresohen këto pretendime përmes ndryshimeve ligjore. Ua rikujtojmë të dy institucioneve që Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit zbatohet pa asnjë dilemë mbi sistemin prokurorial dhe çdo organ tjetër publik të shtetit. Asnjë përjashtim nuk e bën Ligjin në fjalë të pazbatueshëm mbi KPK-në. Argumenti i KPK-së është jo vetëm i pakuptimtë juridikisht, por edhe me qasje tendencioze. Si mund të ngre një pretendim të tillë një organ qendror i luftës ndaj krimit e korrupsionit? Çfarë mendon një zyrtar i lartë publik i korruptuar kur dëgjon një pretendim të tillë nga KPK-ja? Përgjigjet mbi këto pyetje janë natyrisht tregues që kapja e sistemit prokurorial është evidente saqë as kundërshtimet e partnerëve ndërkombëtarë nuk u lënë shenjë tendencave të KPK-së në këtë rast", ka vlerësuar GLPS-ja.

Më tutje, GLPS-ja i ka bërë thirrje KPK-së që të tërhiqet urgjentisht nga qëndrimi i tillë e t'i anulojë konkurset për kryeprokurorë. "I kërkojmë KPK-së të tërhiqet urgjentisht nga një qëndrim i tillë, t'i anuloj konkurset në fjalë dhe ta njoh ekzistencën e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit si legjislacion pozitiv që përfshin edhe sistemin prokurorial. Ministrit Selimi i kërkojmë të distancohet nga minimizimi i problemit dhe të mos bëhet bashkëpunëtorë në procese të tilla të diskutueshme. Kurse KPK të mos vazhdojë me asnjë konkurs të radhës pa përmbushur kushtet që të rikthehen në monitorim Ambasada e ShBA-së dhe Zyra e BE-së. Vettingu është e vetmja zgjidhje për ç'kapjen e sistemit të drejtësisë. Sjelljet e fundit të KPK-së po e forcojnë në çdo çast një argument të tillë", është thënë në reagimin e GLPS-së.

# Kurteshi: KQZ-ja po e pengon të drejtën e votës në Kosovë

**Prishtinë, 12 tetor (ER)** - Përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Sami Kurteshi, ka akuzuar këtë komision për pengimin e të drejtës të votës në Kosovë. Në një konferencë për media, Kurteshi ka thënë se KQZ-ja së bashku me presidentin e vendit, Hashim Thaçi, janë duke i shtyrë zgjedhjet e parakohshme për kryetar të Podujevës. "Është çështja e zgjedhjeve në Podujevë dhe shtyrjes së tyre, e dyta është bllokimi i publikimit të raporteve financiare të partive politike dhe bllokimi i aplikacionit për votim të mërgimtarëve. Ajo çka është duke ngjarë në KQZ është pikërisht e kundërta. Pas shtyrjes kundër kushtetuese të zgjedhjeve nga presidenti, kjo lëndë është duke pritur në Gjykatën Kushtetuese dhe ne si anëtarë të KQZ-së pesë herë e kemi ngritur çështjen e mbajtjes së zgjedhjeve dhe të pestën herë në KQZ është votuar kundër nga përfaqësuesit e partive politike jo vetëm për çështjen e zgjedhjeve, por edhe për ta futur në rendin e ditës duke u arsyetuar në format më banale", ka thënë Kurteshi. Ai ka deklaruar se vendet e rajonit kanë mbajtur edhe zgjedhje të përgjithshme në pandemi. "Në javën e kaluar i kemi dërguar letër z. Naser Ramadani të IKShKP-së për rivlerësim të situatës epidemiologjike se a mund të mbahen zgjedhjet në Podujevë. Vendet e rajonit kanë pasur zgjedhje bile edhe në petkun e pandemisë dhe nuk kemi asnjë të dhënë se mbajtja e zgjedhjeve në cilindo vend të botës mund të ndikojë në rritjen e rasteve me Covid-19. Zgjedhjet janë shtyrë pa afat, që është krejtësisht jokushtetuese. KQZ-ja po e pengon me forma absurde të drejtën e votës në Kosovë. Ajo me veprimet e veta e ka humbur kuptimin e ekzistencës së vet. Atje bëhet çdo përpjekje që e drejta për votim të mohohet në çdo formë të mundshme", ka thënë Kurteshi.



# Nuk kalon projektligji që parasheh heqjen e homologimit të veturave

**Prishtinë, 12 tetor** - Në mungesë kuorumi, nuk ka kaluar në Kuvendin e Kosovës Projektligji për homologimin e veturave i cili është propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Nga 41 deputetë sa morën pjesë në votim, pro këtij projektligji kanë votuar 30 deputetë, 10 kanë qenë kundër, ndërsa një ka abstenuar. Kësisoj, ky projektligj do të hidhet në votim në një seancë tjetër në ditët në vijim. Paraprakisht, deputeti i Vetëvendosjes, Hekuran Murati, i cili ka propozuar ndryshimin e Ligjit për automjete, ka thënë se ata që votojnë kundër heqjes së homologimit janë pro monopolit të "Devollëve".

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka pasur një sërë vërejtjesh për Projektligjin lidhur me kufizimin e homologimit të veturave, të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje. "Sot kemi para vetes një projektligj shumë të thjeshtë, fatkeqësisht shumë keq të arsyetuar dhe gabimisht të shkruar", ka thënë Gashi, teksa ka lexuar disa nga pikat e projektligjit, duke ia bashkangjitur vërejtjet që i ka pasur. Madje një pikë e këtij projektligji, sipas Gashit, është antikushtetues. "Pika pasuese: Lista e shteteve të përcaktuara në paragrafin 1.19 të këtij neni mund të ndryshohet ose plotësohet nga ministria me miratimin e komisionit përkatës parlamentar. Kjo është antikushtetuese. Komisioni parlamentar nuk mund të marrë vendime në emër të Kuvendit. Kuvendi vendimet i merr në seancë", ka thënë Gashi. Për LDK-në, projektligji i propozuar nga LV-ja ka hapësirë për interpretime, ndërsa ka shtuar se duhet të rishikohet në tërësi. Deri atëherë, ka theksuar se ky projektligj nuk votohet nga deputetët e LDK-së.

Në anën tjetër, Bajrush Xhemajli, deputet i PDK-së, ka thënë se janë kundër ndryshimit të Ligjit për automjete që do të nënkuptonte heqjen e homologimit për vetura. Sipas PDK-së, ky ligj i propozuar nga Vetëvendosja është i varfër e se me votimin e tij nuk do të hiqet monopoli. "Ky draftligj është i varfër dhe si i tillë nuk ua merr



homologimin atyre që e kanë sot, as nuk e heq monopolin. Edhe në këtë projektligj mbetet në dorë të ministrave që t'ua japë autorizimet kompanive përkatëse. Nuk hiqet taksa që ka kosto 1.8 milion për qytetarë. Që kur është iniciuar homologimi ka qenë në mungesë të transparencës", ka thënë Xhemajli, duke shtuar se ka pasur mungesë të transparencës gjatë hartimit të këtij dokumenti. "Ky ligj është i mangët, sepse nuk ka transparencë, nuk eliminohet monopoli, nuk rregullohen standardet dhe kriteret. Ky projektligj nuk e ul çmimin për uljen e homologimit. PDK-ja mendon që ky vend në mes të sigurisë rrugore dhe interesin e qytetarëve të hartohet një ligj ku mbrohet interesi qytetar. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozoj që të hiqet ky ligj që ta përmirësojmë ashtu siç duhet, për një pjesë të mediave, që kanë shkruar për punën e mediave, që thotë se përfaqësuesi i PDK-së, unë në komision gjoja kam votuar kundër heqjes siç thonë 'Devollët', është gënjeshtër e kulluar pasi që këto që i thashë sot në Kuvend, i thashë edhe sot", ka thënë Xhemajli. Gjatë diskutimit rreth këtij projektligji është zhvilluar një debat i ashpër në mes të deputetëve të pozitës dhe opozitës.

# Krasniqi kërkon që BE-ja t'i bëjë Serbisë presion për respektim e marrëveshjes së CEFTA-s



**Prishtinë, 12 tetor (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka takuar shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, me të cilin ka biseduar për proceset ekonomike e tregtare në vend, për ndikimin e pandemisë Covid-19 dhe për mundësinë e rimëkëmbjes ekonomike. Krasniqi ka thënë se në këtë takim ka njoftuar zyrtarin e lartë të BE-së se, përveç menaxhimit të pandemisë, kanë punuar edhe për mbrojtje të konsumatorit dhe ndihmë ndaj bizneseve. Ai, po ashtu, ka kërkuar nga BE-ja që ta ushtrojë autoritetin e vet ndaj Serbisë për respektimin e marrëveshjes së CEFTA-s. "E njoftova ambasadorin që krahas menaxhimit të pandemisë jemi angazhuar që ta mbrojmë konsumatorin dhe t'i përkrahim bizneset. Një shqetësim tjetër që adresova tek ambasadori ishin pengesat që shteti fqinj Serbia po i qet për produktet e prodhuara në Kosovë. Kërkova nga BE-ja që ta ushtrojë autoritetin e vet që Serbia t'i respektojë marrëveshjet e arritura për lëvizje të lirë të mallrave në CEFTA", ka njoftuar Krasniqi nëpërmjet faqes zyrtare të vet në "Facebook".

# Shtyhet deri më 31 dhjetor afati për lajmërimin e pensionistëve për pensione

**Prishtinë, 12 tetor** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka njoftuar se e ka shtyrë deri më 31 dhjetor 2020 afatin e lajmërimit për pensionistët, përfshirë përfituesit nga skemat e kategorive të luftës, në zyrat e administratës për pensionet. Në njoftimin e kësaj ministrie është thënë se një vendim i tillë është marrë me qëllim të shmangies së grumbullimeve para sporteleve për shkak të pandemisë Covid-19. "Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes këtij njoftimi njofton të gjithë pensionistët e Republikës së Kosovës (duke përfshirë edhe përfituesit e skemave të kategorive të luftës), të cilët kanë qenë të obliguar të lajmërohen në zyrat e administratës së pensioneve nga muaji mars 2020 e nuk janë lajmëruar për shkak të pandemisë Covid-19, me qëllim të shmangies së grumbullimeve para sporteleve, shtyhet afati i lajmërimit deri më 31 dhjetor 2020, do të thotë se deri në fund të dhjetorit 2020 nuk do të suspendohen nga pagesa", ka njoftuar MPMS-ja.



Nis rehabilitimi i rrugës N25.3 nga Kllokoti deri në Gjilan

# Hoti: Po përmbyllen akset kryesore rrugore në vend

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka marrë pjesë në nisjen e punimeve të rrugës Kllokot-Gjilan. Me këtë rast, Hoti ka thënë se me këtë projekt po përmbyllen akset kryesore rrugore në vend. "Jam i kënaqur që arrijmë ta fillojmë këtë projekt dhe do të vazhdojmë edhe me projekte të tjera të zgjerimit të rrugës që i lidh Vitinë dhe Kllokotin me qasje në autostradë në Ferizaj dhe çështje të tjera që janë në interes të komunës", është shprehur Hoti



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Viti, 12 tetor - Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, bashkë me ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi, kanë vizituar të hënën Komunën e Vitisë, ku janë pritur nga kryetari Sokol Haliti, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, si dhe nënkryetari i Komunës së Kllokotit, Sasha Mirkoviq.

Vizita e kryeministrit Hoti në këtë komunë ka konsistuar me rastin e nisjes së punimeve në "Rehabilitimin e rrugës N25.3 nga Kllokoti deri në Gjilan, projekti i rrugëve regjionale, Lot 2", i mbështetur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), si dhe diskutimin me kryetarët e komunave nga ky regjion për luftën kundër Covid-19.

Kryeministri Hoti fillimisht e ka falënderuar kryetarin e Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, për pritjen dhe punën që e kanë bërë në menaxhimin e pandemisë, duke thënë se është kënaqësi që ta vizitojë këtë komunë. "Ky regjion, Komuna e Vitisë, ka qenë ndër komunat e para që është prekur nga pandemia. Ka pasur një qasje regjionale në menaxhimin e pandemisë që është qasja e duhur, sepse menaxhimi i pandemisë nuk mund të kufizohet brenda kufijve të një komune. Ministrja e Financave ka qenë para një jave dhe është takuar me kryetarët e komunave të këtij regjioni për të diskutuar për projektet e vitit të ardhshëm që do t'i përfshijmë në buxhetin e vitit 2021", është shprehur kryeministri Hoti.

Duke dhënë detaje nga vizita e sotme në Komunën e Vitisë, kryeministri Hoti ka njoftuar se është biseduar për disa projekte specifike, siç është qasja në autostradë në Gërlicë dhe se me ministrin e Infrastrukturës do t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme në mënyrë që ky projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e këtij regjioni të përfundojë sa më parë. "Sot po përurojmë punimet në një aks të rëndësishëm rrugor të cilin e kemi diskutuar dhe i kemi bërë përgatitjet e nevojshme qysh në vitin 2016-2017 në qeveri. Jam i kënaqur që arrijmë ta fillojmë këtë projekt dhe do të vazhdojmë edhe me projekte të tjera të zgjerimit të rrugës që e lidh Vitinë dhe Kllokotin me qasje në autostradë në Ferizaj dhe çështje të tjera që janë në interes të komunës", është shprehur Hoti.

Ndërsa kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka ripërsëritur kërkesën e kyçjes në autostradë në Gërlicë, të cilën e ka paraqitur si shqetësim të kamotshëm të banorëve të kësaj zone. Gjithashtu, ai ka theksuar se rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës Kllokot - Sojevë është nevojë e të gjitha komunave të rajonit të lindjes, ndërkohë që ka potencuar edhe finalizimin sa më të shpejtë të projektit të zonës ekonomike në Budrikë, që ka rëndësi të madhe për sektorin e tregtisë për tërë regjionin e Anamoravës. Pas ceremonisë së prerjes së shiritit, kryeministri Hoti në fjalën e tij tha se ky është një projekt shumë i rëndësishëm i financuar nga BERZh-i dhe se me këtë projekt po mbyllen akset kryesore rrugore në Kosovë, projekte të cilat kanë filluar para 4-5 vjetësh.

# Ministri Mustafa hap Forumin e Politikave Bujqësore



Prishtinë, 12 tetor (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Besian Mustafa, ka bërë të hënën hapjen e Forumit të Politikave Bujqësore (APF). Ky forum është organizim i Grupit të Përhershëm Rajonal të Punës për Zhvillimin Rural (SWG), presidencën njëvjeçare të së cilës për vitin 2020 e ka Republika e Kosovës. Me këtë rast, Mustafa ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19. "Ky bashkëpunim ndihmon në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, veçanërisht pasi rruga jonë si rajon drejt Bashkimit Evropian është në një linjë. Platforma SWG mbetet një shembull i shkëlqyeshëm për këtë bashkëpunim midis nesh dhe ne jemi të përkushtuar drejt zbatimit të konkluzioneve dhe vendimeve që rezultojnë nga kjo platformë", ka deklaruar Mustafa. Forumi i Politikave Bujqësore (APF) është një ngjarje disaditore mbi politikën rajonale bujqësore në Evropën Juglindore, i cili organizohet nga Grupi i Përhershëm Rajonal i Punës për Zhvillimin Rural (SWG), ku aktorë relevantë rajonalë dhe ndërkombëtarë japin rekomandime të politikave rajonale për zhvillim rural.

# Komuna e Malishevës furnizon me farë dhe pleh kimik 549 bujq

Malishevë, 12 tetor (ER) - Në kuadër të investimeve në sektorin e bujqësisë dhe në kuadër të përkrahjes për bujqit lokalë në Komunën e Malishevës, të hënën ka filluar shpërndarja e farës dhe plehut kimik për 549 bujq të kësaj komune. Bujqit të cilët janë përfitues të kësaj përkrahjeje, janë ata bujq të cilët nuk kanë pasur të drejtë të aplikojnë në subvencionet e qeverisë dhe për këtë qëllim janë përkrahur nga komuna.

Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, i ka uruar të gjithë bujqit të cilët janë përfitues për subvencionim me farë dhe pleh kimik. "Ne jemi shumë të kënaqur që e kemi realizuar këtë projekt për përkrahje të bujqve të Komunës së Malishevës, veçanërisht të atyre që nuk i kanë plotësuar kushtet për aplikim në subvencionet e qeverisë, dhe ne nuk i kemi lënë anash as këta bujq", ka thënë drejtori Hoxha. Gjithashtu, ai ka shprehur gatishmërinë e qeverisë komunale për përkrahje të vazhdueshme për të gjithë bujqit dhe fermerët e Komunës së Malishevës.



Drejtori Hoxha ka sqaruar se përfitues të këtij subvencionimi janë të gjithë bujqit të cilët kanë më pak se dy hektarë për mbjellje të grurit. Sipas drejtorit Hoxha, në këtë subvencionim kanë përfituar 549 bujq, ndërsa shuma e projektit është 74 574 euro që financohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

# Mbahet manifestimi letrar 'Flladi i rinisë pranverore letrare' në Kamenicë

Kamenicë, 12 tetor (ER) - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kanë organizuar manifestimin letrar "Flladi i rinisë pranverore letrare" në Kamenicë. Në këtë manifestim kanë qenë pjesëmarrës krijues nga 40 komuna të ndryshme të Kosovës. Gjatë manifestimit nga juria është bërë edhe përzgjedhja e fituesve në fushën e esesë, poezisë dhe pikturës. Në fushën e esesë, fitues janë shpallur: Aulona Haxha nga Klina, Freskita Basha nga Kamenica dhe Fortesa Sejdiu nga Shtimja, ndërsa fitues të poezisë janë shpallur: Ylltare Ferati nga Mitrovica, Blerina Haliti nga Vushtrria dhe Alulona Osmani nga Lipjani. Kurse fituese në garën për pikturë janë shpallur Eliza Kastrati nga Kamenica dhe Diana




Marleku nga Klina.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, gjatë shpërndarjes së çmimeve ka uruar të gjithë fituesit dhe ka përgëzuar të gjithë për punimet e mrekullueshme. Ndërsa drejtori i DKRS-së, Arianit Ibrahmi, duke uruar të gjithë fituesit, ka thënë se drejtoria që ai udhëheq do ta vazhdojë mbështetjen për të gjithë artdashësit e rinj.

# Prehen disa drunj që paraqitnin rrezik për qytetarët e Podujevës

Podujevë, 12 tetor (ER) - Komuna e Podujevës ka bërë me dije se ka larguar disa plepa në afërsi të shkollës "Shaban Shala" dhe në oborrin e tetarit "Avdush Hasani", të cilat, sipas kësaj komune, kanë paraqitur rrezik për qytetarët dhe objektet përreth. "Kompania e kontraktuar nga komuna sot ka prerë dhe ka larguar plepat, të cilët ishin në oborrin e shkollës 'Shaban Shala' dhe në oborrin e Teatrit 'Avdush Hasani'. Këta drunj janë prerë, pasi ishte vlerësuar nga ekspertët se ata paraqesin rrezik për qytetarët dhe objektet përreth, sidomos gjatë reshjeve dhe erërave", ka njoftuar Komuna e Podujevës.



# Komuna e Prizrenit fillon testet serologjike në shëndetësinë primare

Prizren, 12 tetor (ER) - Qytetarët e Komunës së Prizrenit tanimë do të mund të bëjnë teste serologjike për Covid-19 në laboratorin e Qendrës së Mjekësisë Familjare 1. Këto teste që bëhen përmes gjakut, tregojnë nëse personi është ose ka qenë i infektuar me koronavirus dhe pasqyrojnë imunitetin e popullatës, që rrjedhimisht do të ndihmojë në verifikimin e saktë të personave që janë infektuar me Covid-19.

Duke theksuar se kryerja e testeve serologjike ka qenë kërkesë e Komunës së Prizrenit që nga fillimi i pandemisë, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka deklaruar: "Që nga fillimi i pandemisë, Komuna e Prizrenit vazhdimisht ka kërkuar që testet serologjike të kryhen edhe në qytetin tonë. Shpresojmë që Kosova të mos hyjë në valën e dytë të pandemisë, por nëse ndodh një gjë e tillë, Komuna e Prizrenit tanimë është gati për t'u përballur me të".

Nga ana tjetër, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë, Narqize Arënliu-Hoxhaj, ka pohuar se këto teste do të kryhen në bazë të udhëzimeve të mjekëve të institucioneve shëndetësore dhe se rezultatet e tyre do të dalin brenda ditës.



Reagim i KMDLNj-së

# SA LEHTË MASHTROHEMI, POR EDHE NA MASHTROJNË!




Është bërë si rregull që për çdo dështim, edhe nëse nuk ka qenë apo është përgjegjësi e institucioneve të vendit, që këto institucione të fajësohen, sidomos nga partitë opozitare e që në këtë rrafsh nuk dallojnë aspak nga mediat dhe shoqëria civile. Nuk diskutohet se në raste të caktuara përgjegjësia e institucioneve të vendit është e pakundërshtueshme, mirëpo gjithnjë duhet ta kemi parasysh faktin se ushtrimi i pushtetit efektiv apo vendimmarrja (kryesisht nga pozita e këshillëdhënësit apo lehtësuesit, si maskim) ka qenë te ndërkombëtarët.

Pas përfundimit të luftës, shtyllat kryesore të shtetit janë udhëhequr nga ndërkombëtarët; drejtësia, ekonomia, arsimi, doganat, financat etj. janë udhëhequr nga ndërkombëtarët, kurse klasa politike e vendit ka pasur për detyrë t'ua mbajë zhagun. Si shpërblim, nga ndërkombëtarët kanë pasur të drejtë të bëjnë ç'të duan me qytetarët e vendit dhe në këtë kontekst kanë përfituar materialisht, pa u ndëshkuar fare për faktin se ndërkombëtarët kanë pasur ekskluzivitet për rastet me ndjeshmëri të lartë si krimet e luftës, krimet ndëretnike dhe rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Pas përfundimit të luftës kur një Gjykatë vendore e dënoi një serb për krime lufte, rasti Trajkoviq nga Gjilani, ndërkombëtarët e anuluan procesin duke e liruar nga çdo përgjegjësi dhe nga ai rast morën të gjitha përgjegjësitë për rastet e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Ka shumë raste kur ndërkombëtarët kanë ndikuar sikur që mundësuan "ikjen" e 20 serbëve dhe një romi të dyshuar për krime lufte nga Burgu i Mitrovicës dhe asnjëherë nuk kanë kërkuar që këta të ekstradohen nga Serbia. Pas publikimit të raportit politik të Dik Martit për të ashtuquajturën Shtëpinë e Verdhë të kapuçëve në Shqipëri për nxjerrje dhe trafikim të organeve njerëzore (kryesisht të serbëve) dhe pasi Policia e Kosovës arrestoi disa serbë që jepnin shuma të mëdha parash në Kosovë, në përpjekje për të rekrutuar dëshmitarë kinse u janë marrë organet dhe pasi u mbajtën disa muaj në paraburgim, me presionin e Serbisë dhe ndërkombëtarëve këta u liruan kurse disa media dhe OJQ vendore thyenin këmbët duke kërkuar nëse do të gjejnë ndonjë organ të nxjerrë në Shtëpinë e Verdhë, me inkurajimin dhe financimin e ndërkombëtarëve.

Në këtë mënyrë përpiqeshin të mbështesin një raport monstruoz të Dik Martit për trafikim të organeve të cilin e mohuan edhe autoritetet profesionale të Serbisë kurse e përkrahën politikanët e Serbisë dhe ndërkombëtarët në Kosovë të cilët terrorizuan deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta votojnë një Gjykatë Speciale e cila, nga aspekti i universalitetit të të drejtave të njeriut, viktimat i diskriminon skajshmërisht për faktin se angazhohet për të drejtat e viktimave në baza etnike e që përbëjnë vetëm 5 për qind të viktimave të përgjithshme kurse, ua mohon të drejtën elementare të njeriut 95 për qind të viktimave sepse nuk trajton fare këto raste. Edhe ata pak serbë që janë arrestuar në Kosovë për krime lufte, nën presion politik, ose janë liruar ose janë dënuar me dënime simbolike. Shihni raportet dhe përqindjet e të vrarëve në Kosovë sikur edhe të të dënuarve dhe vëreni një shpërputhje të madhe ku 90 për qind të të arrestuarve për krime lufte janë shqiptarë kurse vetëm 10 për qind janë serbë kurse raporti për viktima është më shumë se 90 për qind janë shqiptarë dhe më pakë se 10 për qind janë serbë dhe pakica tjera. Realisht, gjyqësori i Kosovës padrejtësisht fajësohet pse nuk e ka formuar një Gjykatë Për Krime Lufte aq më parë që KMDLNj përmes kryetarit prof. Pajazit Nushi, pas vendimit të Kryesisë, në takim me ndërkombëtarët ka kërkuar që të formohet një Gjykatë që do të merrej vetëm me raste të krimeve të luftës. Përgjigja e ndërkombëtarëve ka qenë; për raste kapitale merret Tribunali për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë kurse, për raste tjera janë ndërkombëtarët në Kosovë. Kjo është e vërteta. Ndërkombëtarët e kanë pamundësuar, sigurisht për qëllime politike formimin e një gjykate të tillë për ta formuar, kur e kanë ndjerë të nevojshme, gjithashtu për qëllime politike një Gjykatë Speciale që punon sipas ligjeve të Kosovës (për ata që janë të marrë ndoshta është e besueshme) por që, në fakt, nuk ka të bëjë asgjë me Kosovën përveç se të gjithë të arrestuarit dhe të dënuarit eventual janë shtetas të Kosovës (shqiptarë) sikur që paralajmërohen se mund të ketë arrestime edhe në Shqipëri apo Maqedoni të Veriut (edhe këta shqiptarë). KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon drejtësi për të gjitha viktimat, pa asnjë dallim sikur që kërkon përgjegjësi për të gjithë ata që kanë bërë krime, gjithashtu, pa asnjë dallim. Ndërkaq, bashkësia ndërkombëtare ka qëndrim tjetër sepse gjykimet për krime lufte i konsideron si mundësi presioni për arritje të qëllimeve politike, gjithnjë në emër të ruajtjes së paqes dhe normalizimit të marrëdhënieve midis shteteve ndërluftuese. Bashkësia ndërkombëtare ka dështuar në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur duke krijuar ekipe për bisedime dhe duke stërzgjatur këto bisedime në përputhje me zhvillimet politike dhe për qëllime politike në ndërkohë që ka pasur mundësi por edhe detyrim të bëjë presion te palët ndërluftuese (pas përfundimit të luftës) të tregojnë për fatin e këtyre personave. Nga kjo duket qartazi, mbështetur në shumë raporte ndërkombëtare si dhe deklarata të hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë (pas përfundimit të mandatit apo shkarkimit të tyre ) se pikërisht korrupsioni ka përcaktuar dinamikën dhe vendimet gjyqësore për krime lufte ku janë montuar procese kundër personave të caktuar dhe ku është shitur pafajësia për ata të cilëve edhe një student i vitit të parë i fakultetit të drejtësisë do ta arsyetonte fajësinë. Po në këto raste është perfeksionuar sekserizmi i disa avokatëve dhe legalizimi i korrupsionit duke prodhuar mosndëshkueshmërinë për fajtorët sikur që edhe duke ua mohuar të drejtën elementare të viktimave për drejtësi dhe satisfakcion. Viktimat dhe drejtësia janë humbësit më të mëdhenj dhe përsëri, për shkak të oportunitetit politik janë shndërruar në viktima, janë riviktimizuar disa herë. Prandaj, në rrethana aktuale ku interesi politik është mbi interesin e drejtësisë, KMDLNj vlerëson si improvizim çdo përpjekje për Ballafaqim me të kaluarën kurse krejtësisht utopike çfarëdo Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtim. Ndërkombëtarët dhe vendorët duhet të mbledhin njëherë e mirë mend se nuk ka drejtësi nëse të gjitha viktimat nuk trajtohen si viktime dhe, në këtë kontekst drejtësia është ajo që e ka fjalën e fundit dhe të vetme dhe se nuk ka dhe nuk duhet të ketë kurrfarë amnistie për ata që u dëshmohet se kanë bërë krime lufte apo krime kundër njerëzimit. Nuk ka drejtësi selektive sikur që as nuk ka përgjegjësi selektive. KMDLNj mund të faktojë me qindra raste ku drejtësia për viktimat po sakrifikohet për qëllime politike. Ndërhyrja dhe ndikimi politik ka shkuar aq larg dhe u bë aq i paturpshëm sa që, 22 vjet pas përfundimit të luftës Kosova kushtëzohet me kërkesa politike që janë punë e brendshme e Kosovës e që e rrezikojnë integritetin e shtetit kurse sovraniteti është diçka për të dëshiruar. Kosova nuk ka dështuar në gjykimin e rasteve të krimeve të luftës as në programin e mbrojtjes së Dëshmitarëve të Mbrojtur sepse kjo ka qenë dhe ende vazhdon të jetë përgjegjësi e ndërkombëtarëve që nuk e kanë bërë këtë në kohën e duhur. Tash, 22 vjet pas përfundimit të luftës kur shumë dëshmitarë nuk janë gjallë apo për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore nuk janë dëshmitarë të besueshëm, ndërkombëtarët ua kanë lënë në duar këmbët e arushës hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve vendorë të cilët, edhe ashtu nuk kanë pasur përvojë dhe profesionalizëm të mjaftueshëm (me përjashtim të një grupi të vogël) duke i akuzuar për efikasitet të ulët prandaj paska qenë e arsyeshme dhe e nevojshme formimi i Gjykatës Speciale e që është në kundërshtim të plotë me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara sepse në mënyrë flagrante diskriminon viktimat dhe siguron mosndëshkueshmëri për pjesën dërrmuese të atyre që kanë bërë krime.

Qytetarët e Kosovës janë të privuar nga liria e lëvizjes, e drejtë e njeriut e që është shndërruar në standard te të gjitha vendet e BE-së, kryesisht për qëllime politike. Ishte kusht Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi dhe pasi u votua në Kuvendin e Kosovës (shumë i dyshimtë për integritetin territorial të vendit) dolën kërkesa të tjera sikur mungesa e luftës kundër korrupsionit të profilit të lartë në ndërkohë që të gjithë ndërkombëtarët ngushtë punonin e në raste të caktuara edhe bashkë keqpërdornin fonde publike dhe të tjera. U tha se gjatë udhëheqjes së BE-së nga Gjermania do të ketë liberalizim të vizave sepse Kosova i paska plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe tash po del se nuk ka asgjë nga liberalizimi sepse disa shtete po e kundërshtojnë. Duket se kërkohen të plotësohen kushte ekskluzivisht politike, lëshime apo kompromise të dhimbshme me Serbinë në ndërkohë që Serbia mbetet e paprekur nga këto kushtëzime për faktin se të gjitha betejat politike dhe diplomatike bëhen për territorin e Kosovës dhe çështjet e brendshme të Kosovës. Madje, një kundërshtar i fuqishëm i pavarësisë së Kosovës dhe një mik i madh i Serbisë, tash i dërguar i BE-së për këto bisedime, Miroslav Lajçak paturpësisht deklaron se Asociacioni i Serbisë në Kosovë duhet të formohet sepse qenka nënshkruar Marrëveshja në Bruksel e që të njëjtën këngë e këndon edhe Aleksandër Vuçiqi, përgjegjës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë, tash partner i besueshëm dhe i preferuar i BE-së. U fol se edhe Riçard Grenell, gjatë vizitës së fundit në Kosovë do ta sjellë lajmin e dëshiruar se SHBA-të do të heqin vizat për qytetarët e Kosovës e që doli të jetë mashtrim i radhës. Nuk është se është gjendja shumë e mirë në Kosovë por a mos është gjendja më e mirë në federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe vendeve tjera të rajonit e që kanë përfituar në çdo aspekt ndërkaq qytetarët e Kosovës kanë mbetur "leprozët" e fundit në Ballkan dhe Evropë prandaj mbahen të izoluar ndërkaq politikanët e vendit që akuzohen nga ndërkombëtarët për të gjitha të gjeturat e raporteve të progresit dhe të regresit i gëzojnë të gjitha të drejtat. Nuk ka korrupsion të profilit të lartë apo të ulët dhe drejtësia nuk njeh këso cilësime sikur që OJQ-të dhe shoqëria civile nuk janë adresa kryesore për luftimin e korrupsionit e lëre më të krimeve të luftës. Ato mund dhe duhet t'i bëjë vetëm shteti kurse OJQ-të mund të kontribuojnë për këtë por nuk janë adresa për vendimmarrje!

# TE ALI AHMETI NË TETOVË ME MASKA TË PANDEMISË



Ismet SYLEJMANI

Tashmë dihet botërisht, se Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti për çlirimin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës nga Serbia pushtuese, i kishte vënë të gjitha, kishte vënë gjithëçka të jetës së Tij!
Ali Ahmeti, në tërë jetën e Tij, që pa as më të voglin dyshim, është jetë e madhe dhe e jashtëzakonshme luftëtari shqiptar, luftën për lirinë, për çlirimin dhe për pavarësinë e Kosovës e ka pasur në plan të parë!
Prej vitit 1981, pra prej atëherë kur shpërtheu vullkani i atij viti të pashembullt historik për shqiptraët, që nga ajo kohë, roli i Abaz Gjukës, ishte jo vetëm rol vendimtar, por kontributi i Tij për Kosovën e çështjen shqiptare ka qenë vazhdimisht e gjithmonë në rritje, i gjithanshëm e katërciperisht progresiv, integrues!
Njëri nga bijtë më të mëdhenj të popullit, të Atdheut e të Kombit Ali Ahmeti, sikur edhe asnjë tjetër rast i vetem në histori, nga pjestarët e thjeshtë e deri te ata me merita të mëdha e kolosale, është i vetmi aktorë e faktorë prej personaliteti shqiptar që jo vetëm mori pjesë në themelimin e tri ushtrive çlrimtare në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni, por në tërë këtë trekëndësh historik shqiptar në ish-jugosllavi, jo vetëm i themeloi por edhe i drejtoi e komandoi me TO!
Në luftën heroike e të armatosur çlirimtare të UÇK-së që komandoi në Maqedoni dhe me te arriturat e mëdha që realizoi pas luftës e deri te hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO, Ali Ahmeti u bë emblema e madhe e personalitetit kombëtar të padiskutueshëm dhe të pacenueshëm!
Është mëkat prej Zotit po edhe prej popullit, është mëkat ndaj Atdheut e është mëkat edhe ndaj Kombit, që Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti të mos përkrahet e të mos mbështetet fuqishëm nga të gjithë shqiptarët në rrugën e Tij të shtrenjtë e të shenjtë kombëtare, atë të realizimit të ëndrrave shekullore të të parëve tanë, të Rilindasve e të qindra dhe mijëra patriotëve, që i kanë mbyllur sytë dhe kanë shkuar në atë botë me merakun se si do të jetë e ardhmja!
Ali Ahmeti tërë jeten e Tij, pa asnjë mëdyshje e pa asnjë kalkulim personal, e nxorri në ankand nacionl të çështjes shqiptare në përgjithësi, por edhe të Kosovës e viseve të saja në veçanti dhe tash jo vetëm qeverisë me suksese të mëdha e të arritura vendimtare në Maqedoninë e Veriut, por me fuqinë e madhe të personalitetit të Tij, është vënë në shërbim të stabilitetit në rajon dhe më gjerë!
Me aktivitet e me veprimtari politike atdhetare e kombëtare, Ali Ahmeti me largëpamësinë, trimërinë dhe sinqeritetin, është njëri prej pasardhësve më origjinal i të mëdhenjëve gjenial të Kombit shqiptar!
Popujt e kombet e mëdha, të lashta e me kulturë fundamentale njerëzore, personalitetet sikur Ali Ahmetin i kanë të rrallë, por edhe më të rrallë i kanë shqiptarët!
Orën shpirtërore e morale të Ali Ahmetit me atë të orës së Kombit shqiptar, nuk e ndal asgjë!
Ali Ahmetin nuk e ndalë as pandemia, kjo e keqe e madhe që e kërcënon me vdekje çdo qenie njerëzore në botë!
Historia e popullit shqiptar, koha do ta dëshmojë, se do të identifikohet edhe me epokën e ndritur të Ali Ahmetit!

**Prishtinë, 10.09.2020!**




Sport




# Kosova humbet minimalisht ndaj Sllovenisë



**Prishtinë, 12 tetor** - Kosova ka pësuar të dielën humbje 1-0 në shtëpi në përballjen ndaj Sllovenisë në kuadër të Ligës së Kombeve. Ndeshja ka filluar mirë për "Dardanët", që zhvillonin një lojë të rrjedhshme dhe tentonin të dilnin përpara. Me disa kombinime të mira të lojtarëve të Kosovës ishin pranë portës së Jan Oblak, mirëpo u mungonte saktësia. Arbër Zeneli dhe Valon Berisha kishin disa kombinime të mira, derisa ty u përfshi edhe Benjamin Kololli, por pa ndonjë rezultat. Bernard Challandes mbeti i frustruar nga ky aksion i papërfunduar mirë, duke kërkuar më shumë përqendrim. Ishte minuta e 22-të kur Haris Vuckic pranoi një asistim të mirë nga Sandi Lovric dhe shënoi në portën e Aro Muriçit, derisa mbrojtja jonë kërkoi pozitë jashtë loje. Një kombinim i mrekullueshëm i lojtarëve të Kosovës erdhi në minutën e 35-të, ku Zhegrova dhe Berisha ishin arkitektë, por goditja finale e Zenelit përfundoi jashtë portës. Pak sekonda më vonë, Zeneli bëri një gjuajtje të fuqishme, mirëpo Oblak intervenoi për mrekulli.

Ishte minuta e 43-të kur Jan Oblak pret goditjen e Leart Paqaradës, ndërsa më pas një tjetër rast të mirë e pati Bersant Celina por sërish portieri slloven ishte në vend. Pjesa e dytë filloi disi më e qetë dhe të dyja skuadrat ishin të rezervuara. Por, me kalimin e minutave Bernard Challandes kërkoi nga lojtarët që të jenë më agresivë dhe të dilnin më shumë përpara. Ishte minuta e 63-të kur Zeneli dribloi disa kundërshtarë nga e majta, por depërtimi është i pamundur. Përpjekje për të dribluar bën edhe Zhegrova dhe në fund tanët e humbin topin. Sllovenia më pas ndërtoi një aksion të rrezikshëm, mirëpo që Florent Hadërgjonaj ishte i shpejtë dhe rrëmbeu topin për të kaluar më pas tek Aro Muriç. Në minutën e 78 Challandes largoi nga fusha Arbër Zenelin dhe në vend të tij futi Lirim Kastratin. Ndeshja vazhdoi me një ritëm të njëjtë dhe me aksionet që bllokoheshin nga të dyja anët. Në fund, Sllovenia mori tri pikë mjaft të vështira për t'u plasuar kështu në vendin e dytë me shtatë pikë, aq sa ka Greqia që mposhti Moldavinë me rezultat 2-0.

Pas ndeshjes trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se ai është i kënaqur me punën që kanë bërë lojtarët, mirëpo që pranuam një gol të lehtë. "Unë kam menduar që ky formacion ishte më i miri edhe pse ishte pothuajse i ngjashëm me Maqedoninë e Veriut", ka thënë Challandes. Ai ka thënë se ka vendosur të luajë me Kolollin si sulmues pasi kishin probleme për të shënuar në këtë kohë. "Skuadra ka luftuar deri në fund, mirëpo duhet ta pranojmë se asgjë nuk po na shkon aktualisht. Duhet ta mbajmë kokën lartë dhe të punojmë. Unë i shikoj lojtarët që kam dhe nuk kam problem që t'i njoh kapacitetet. Për mua lojtarët që kanë luajtur janë më të mirët që kishim", ka thënë Challandes, duke shtuar se lojtarët nuk e kanë bërë punën e tyre. "Jam i zhgënjyer me lojtarët dhe me këtë paraqitje, pasi pranuam një gol lehtë dhe unë duhet ta mbroj skuadrën time, pasi ata tentuam, provuan, por ne duhet të punojmë më shumë. Nuk mund të them që lojtarët nuk e kanë bërë punën e tyre", ka deklaruar trajneri i Kosovës.

# Katër futbollistë dhe një anëtar i stafit të Kombëtares U21 dalin pozitivë me Covid



**Prishtinë, 12 tetor (ER)** - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar opinionin se Kombëtarja U21 të dielën i është nënshtruar testit për Covid-19 dhe të hënën është njoftuar me rezultatet e testeve. Me këtë rast katër futbollistë dhe një anëtar i stafit kanë rezultuar pozitivë, por që të gjithë janë asimptomatikë dhe mirë me shëndet. "Menjëherë pas njoftimit të rezultateve të testeve të gjithë personat që kanë rezultuar pozitivë janë izoluar dhe nuk kanë kontakt me pjesën tjetër të ekipit. Po ashtu, duhet cekur që Federata edhe më herët i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për këtë grumbullim, ku të gjithë futbollistët kanë qenë në dhoma të ndara që nga fillimi. Personat që kanë rezultuar pozitivë janë ritestuar gjatë ditës së sotme në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe janë në pritje të rezultateve për t'u konfirmuar nëse sërish janë pozitivë", ka njoftuar FFK-ja.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:295:/1
Dt: 12.10.12020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032,Neni 4 dhe 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe AftësiminProfesional04/L-138, Neni13dhe34,Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012(Neni4),Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018,Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

# KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira në Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren, Sh. M. M "Shtjefën Gjeçovin" në Prishtinë si dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita/Vend i ilirë | Vendi lirë/ Zëvendësim |
|---|---|---|---|---|
| **SHMLT** | **"11 Marsi''** | **Prizren** | Një (1) mësimdhënës/e të Dizajnit të Veshjes; normë e plotë | deri më 10.07.2021 |
| | | | Një(1) mësimdhënës /e të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe; gjysmë norme | deri më 31.08.2021 |
| | | | Një(1) mësimdhënës /e të Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit; 15 orë mësimore; | deri më 31.08.2021 |
| | | | Një(1) mësimdhënës/e të Matematikës për mësim në Gjuhën Boshnjake; 17 orë mësimore; | deri më 31.08.2021 |
| | | | Një(1) Instruktor të TIT-it | Vend i lirë |
| **SHML** | **Qendra e Kompetencës** | **Ferizaj** | Një(1) mësimdhënës /e të Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit, me normë të plot; | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
| | | | Një(1) mësimdhënës/e për profilin Siguri e Ushqimit dhe Dietat | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
| **SHML** | **Qendra e Kompetencës** | **Ferizaj** | Një (1) punëtor/e teknik | Vend i lirë |
| **Sh. M. M** | **"Shtjefen Gjeqovi"** | **Prishtinë** | Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Teknikat e Ndërtimit 10 orë mësimore; | Vend i lirë |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**
- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:**

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikes profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikes profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:**

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të këtë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik**
- Bën mirëmbajtën e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve
- teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtese të cilat i ndan drejtori i shkollës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:**
- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenën gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe
- Shkallë të lartë integriteti,

**Aftësitë shtesë**
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues si
- Dhe personelit të Shkollës.

Paga: koef. 4
Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj
Orari: 40 orë pune në javë

**Procedurat e konkurrimit:**
Afati i konkurrimit është 15ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren, Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Sh. M. M "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë.
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen.
Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 292/1
Dt: 12.10.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

# Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

**Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita/Vend i ilirë | Vendi lirë/ Zëvendësim |
|---|---|---|---|---|
| SHML | Qendra e Kompetencës | Ferizaj | Një (1) mësimdhënës/e për lënden e Matematikës 20 orë mësimore: | Vend i lirë |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceset mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

**Procedurat e konkurrimit:**

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen.
Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin me vete dokumentet origjinale.
Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

**Komuna Junik**
**Dt.24.09.2020**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Para universitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Junikut shpallë:

## KONKURS

Për plotësim e stafit mësimdhënës për orët profesionale

**Gjimnazi "Kuvendi i Junikut" në Junik**

Një (1) mësimdhënës/e për lëndët profesionale në drejtimin mjekësi e përgjithshme për 15 orë mësimore në javë.

**KUSHTET:**

- Për vendin e lirë të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse (Mjek/e i përgjithshëm).

**DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:**

1. Diploma (certifikata),
2. Çertifikata e lindjes,
3. Letërnjoftimi i fotokopjuar,
4. Dëshmi për përvojën e punës,
5. Dëshmi për trajnimet arsimore,
6. Certifikatë e shtetësisë,
7. Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime
8. Vërtitim nga Zyra e Punësimit.

Luteni që të dorëzoni vetëm kopjen e vërtetuar/noterizuar të dokumenteve të listuara më lartë. Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik, dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim. Afati i konkurrimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore.
Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushte për intervistë njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor, kandidatët janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar ne aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë

*Nr.Prot:87/2020*
*Datë:* ***12.10.2020***

Gjimnazi "Hamdi Berisha", shpallë:

## FTESË PER OFERTË

**QËLLIMI**: Sigurimi i uniformës për nxënësit e klasave të **X-ta**

**Kriteret**: Uniforma duhet të jetë për meshkuj vetëm **pallto** me emblemë të shkollës, si dhe për femra **pallto** duhet të jetë me emblemë me kallan dhe e gjatë deri tek gjuri, çmimi i volitshëm dhe mundësitë për një çmim më të arsyeshëm për nxënës me ekonomi të dobët familjare.

Ofertuesit duhet t'i ofrojnë modelet e tyre në administratën e shkollës. Ofertat duhet të dorëzohen deri më datë **16/10/2020**, ditë e Premtë në orën **14:00** kur do të hapen ofertat në prani të komisionit.

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë, i ka mbi **500** nxënës, meshkuj **220**, femra **280.**

.

Për informata të tjera mund të kontaktoni me këta numra të telefonave: **044/269-758.**










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Çlirim Alija shpall te pa vlefshme dëftesat e kl X,XI,XII diplomën dhe certifikatën e testit maturës se Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

▶ Egzon Alija shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII, diplomën dhe certifikatën e testit maturës se Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

▶ Dafina Pula shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi " ne Gjakovë.

▶ Ferid Xhahnemi shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U. "Mazllom Kepuska" ne Gjakovë.

▶ Trendelina Gjocaj shpall te pa vlefshme dëftesën e kl.X te Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

▶ Ergyner Halabak shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Befasim Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Ehad Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së –VI –IX, të shkollës fillore "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

▶ Bujar Lepaja, nga Prishtina shpall te pavlefshme diplomën e SHMEJ " Hoxhe Kadri Prishtina" Prishtinë.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905